



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7207 Nr. i faq/Br.str/No.pg 23
Data/Datum/Date 14/04/26
RAHOVEC / ORAHOVAÇ



KOMUNA E RAHOVECIT
RAHOVEC MUNICIPALITY

Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"

Pranuar me dt. 14.04.2026
Zyra e pranimit Nr. i protokollit
308 01-98

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN
DHE
KOMUNËS SË RAHOVECIT**

Neni 1

Hyrje

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme marrëveshje) lidhet ndërmjet Komunës së Rahovecit (në tekstin e mëtejme Komuna), e përfaqësuar nga kryetari, z. Smajl Latifi dhe Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren (në tekstin e mëtejme Universiteti), e përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani.

Neni 2

Qëllimi

2.1.Me këtë marrëveshje mirëkuptimi qëllimi dhe vullneti i lirë dhe i mirë i palëve në **Nenin 1** të kësaj marrëveshjeje, për angazhimin e 3 (tre) praktikantëve për punë praktike me pagesë në kohëzgjatje prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj gjatë vitit 2026.

2.2.Praktika në punë do të realizohet pranë zyrave përkatëse të Komunës së Rahovecit.

Neni 3

Baza e Bashkëpunimit

Baza e bashkëpunimit për realizimin e kësaj marrëveshje është legjislacioni i aplikueshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës së Rahovecit

- 4.1. Bashkëpunon me Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren dhe strukturat organizative të saj rreth realizimit të praktikës në punë për 3 (tre) praktikant/e.
- 4.2. Mundëson mbrojtjen, sigurinë dhe kushte të përshtatshme të punës për pjesëmarrësin sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe siguron ambiente të punës brenda zyrave ku do të angazhohet praktikanti/ja;
- 4.3. Siguron që praktikantët/et gjatë angazhimit të tyre prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj do të përvetësojnë njohuritë dhe shkathtësitë themelore të punës në zyre/administratë dhe se do të jenë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të angazhimit;
- 4.4. Komuna e Rahovecit do të kompensojë në shumën prej 100€ (njëqind euro) të pagës mujore të praktikantit të angazhuar për periudhën prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

- 5.1. Përcaktimin e dinamikës së aktiviteteve lidhur me realizimin e praktikës në punë së bashku me komunën e Rahovecit.
- 5.2. Bashkëpunon me Komunën e Rahovecit dhe strukturat organizative të saj rreth realizimit të praktikës në punë për 3 (tre) praktikantë për punë praktike me pagesë në kohëzgjatje prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj.

Neni 6

Mosmarrëveshjet eventuale

Palët në këtë marrëveshje pajtohen se për çdo mosmarrëveshje apo keqinterpretim lidhur me natyrën dhe qëllimin e bashkëpunimit që del nga kjo marrëveshje, do të zgjidhet përmes dialogut-bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve do të jetë Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec.

Neni 7

Zbatimi

Palët pajtohen se do të kujdesen me përkushtim për zbatimin me përpikëri të kësaj marrëveshje.

Neni 8

Afati kohor i vlefshmërisë së marrëveshjes

Palët pajtohen se afati kohor i vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje do të jetë nga momenti i angazhimit të praktikantëve e deri në përfundim të praktikës prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, me mundësi të shkëputjes së kësaj marrëveshjeje në çdo kohë, vetëm me parashtrimin e kërkesës paraprake me shkrim nga njëra prej palëve në këtë marrëveshje, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nëse praktikantët nuk kanë treguar sukses në punë.

Neni 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja është nënshkruar në 3 (tre) ekzemplarë identik origjinal, ku nga 1 (një) kopje origjinale e marrin secila palë nënshkruese.

Neni 10

Efektet juridike

Kjo marrëveshje do të fillojë të prodhoj efekte juridike në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Nënshkruar më: 14 / 04 / 2026, në Rahovec.

Rektori:

Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani

Për 


Kryetari i Komunës:

z. Smajl Fatifi


